Enveo Therm

SISTEME FASADE QË SHKËLQEJNË GJITHMONË

EnveoTherm Excellent

SISTEM TERMOIZOLIMI FASADE ME POLISTEROL OSE GRAFIT POLISTEROL

EnveoTherm Excellent është një sistem fasade i çertifikuar, i projektuar për objekte banimi dhe tregtare, i përshtatshëm si për ndërtime të reja ashtu edhe për rinovime të strukturave të vjetra. Jetëgjatësia dhe izolimi termik i sistemit sigurohen nëpërmjet produkteve të përzgjedhura Enveo, të cilat, kur kombinohen, ofrojnë një sistem fasade cilësor, të krijuar për ta mbrojtur fasadën. Elementi izolues i sistemit mund të përbëhet nga polisterol i bardhë ose grafit polisterol, ndërsa shtresa e fundit dekorative ofron munësinë e zgjedhjes midis suvave të fasadës silikate dhe silikoni.

Avantazhet e sistemit te fasades

- Mbron elementët strukturorë dhe zgjat jetëgjatësinë e ndërtesës
- Kursen energji gjatë ngrohjes dhe ftohjes
- Parandalon urat termike dhe përmirëson cilësinë estetike të fasadës
- Rrit vlerën e ndërtesës
- Krijon një ambient të brendshëm më të rehatshëm
- Sistem i çertifikuar ETA

weber SAINT-GOBAIN

SAINT-GOBAIN

Enveo Therm

weber SAINT-GOBAIN

EnveoTherm Excellent

Përbërja e sistemit të fasadës ENVEO

KOMPONENTI	PRODUKTI	KONSUMI
Ngjitësi i termoizolimit	EnveoTherm Excellent	≥ 5.0 kg/m²
Paneli izolues	EPS i bardhë / EPS Grafit	1.0 m²/m²
Upa / Tiplla	Të gjitha të çertifikuara ETAG 014	≥ 5 pcs/m²
Rrafshuesi për rrjetën e fasadës	EnveoKleber Excellent	≥ 5.0 kg/m²
Rrjetë fasade me fibra qelqi	EnveoTherm Mesh 117 50	1.1 m/m²
Astar/Bazë për fasada	Enveo Grund	0.25 kg/m²
Suva dekorative	EnveoPutz Premium Aqua / EnveoPutz Premium Clean / EnveoPutz Premium Silicon / EnveoPutz Premium Active / EnveoPutz Silicon / EnveoPutz Silicate	2.0–3.5 kg/m²

Udhëzime mbi aplikimin

1. Ngjitja e paneleve të termoizolimit

Ngjisni panelet termoizoluese të poisteroli të bardhë ose grafit polisteroli në bazamentin e përgatitur më pare, duke përdorur ngjitësin EnveoTherm Excellent duke aplikuar metodën perimetër-pik. Kur ngjisni panelet, vendosini ato pranë njëra-tjetrës, duke siguruar që fugat të mos përputhen me skajet e hapjeve të fasadës. Udhëzimet e hollësishme për përgatitjen e bazamentit, përgatitjen e ngjitësit dhe instalimin e produktit mund të gjenden në fletën e të dhënave teknike të produktit nëpërmjet kodit QR ose në faqet tona www.testisthebest.com

2. Fiksimi me upa/tiplla

Fiksimi i termoizolimit me upa/tiplla mund të kryhet jo më shpejt se 48 orë pas ngjitjes. Vendosni upat/tipllat në skaje dhe në qendrën e paneleve termoizoluese. Numri minimal i upave/tipllave për m² duhet të jetë së paku 5; megjithatë, numri i saktë duhet të llogaritet nga një Inxhinier, bazuar në lartësinë e ndërtesës, fuqinë e erës në zonën e objektit, etj. Udhëzime të hollësishme rreth produktit mund të gjenden nëpërmjet kodit QR ose në faqet tona www.testisthebest.com

SAINT-GOBAIN

Enveo Therm

weber SAINT-GOBAIN

EnveoTherm Excellent

3. Rrafshimi me rrjetë përforcuese fasade

Zbatoni shtresën rrafshuese të termoizolimit me ngjitësin EnveoKleber Excellent. Përpara se të përforconi sipërfaqen e plotë, vendosni profilet e nevojshme me rrjetë (këndore, pikatore, profile izoluese, etj.) dhe përforcime në qoshet rreth hapjeve. Përforconi gjitë sipërfaqen me rrjetën e fasadës EnveoTherm Mesh 117 50 / EnveoTherm Mesh 131 50, duke siguruar një mbivendosje prej 10 cm në mënyrë që trashësia totale e shtresës pas mbulimit të rrjetës me ngjitës të jetë së paku 4 mm. Gjatë instalimit, vendoseni rrjetën brenda të tretës së jashtme të shtresës rrafshuese për të siguruar rezistencë të lartë të sistemit ndaj ndikimeve të jashtme. Udhëzimet e hollësishme rreth produkteve mund të gjenden nëpërmjet kodit QR ose në faqet tona www.testisthebest.com

4. Aplikimi i Astarit/Bazës së Fasadës

Aplikoni astarin/bazën Enveo Grund në një ose dy shtresa, mbi shtresën rrafshuese të EnveoKleber Excellent të tharë mirë. Është thelbësore që sipërfaqja të mbulohet tërësisht me astar/bazë të bardhë ose të ngjyrosur sipas ngjyrës të suvasë së fasadës nga sistemi EnveoTherm Mix. Udhëzime të hollësishme rreth produktit dhe aplikimit të tij mund të gjenden nëpërmjet kodit QR ose në faqet tona www.testisthebest.com

5. Aplikimi i Suvasë Dekorative të Fasadës

Përpara përdorimit, përzieni tërësisht suvanë e gatshme EnveoPutz dhe përgatitni materialin për sipërfaqen e caktuar. Pas kësaj, vazhdoni me aplikimin e produktit në mënyrë të sinkronizuar, duke lidhur dhe punuar fugat e materialit të aplikuar në gjendje të njomë, për t'u siguruar që ato të mos jenë të dukshme pas përfundimit. Temperatura e ajrit dhe e bazamentit gjatë aplikimit dhe tharjes nuk duhet të jetë më e ulët se +5°C ose më e lartë se +30°C. Mbroni materialin nga kushtet e pafavorshme atmosferike për të paktën 24 orë. Udhëzimet e hollësishme rreth produkteve mund të gjenden përmes kodit QR ose ose në faqet tona www.testisthebest.com

SAINT-GOBAIN

SAINT-GOBAIN GRAĐEVINSKI PROIZVODI D.O.O. BEOGRAD
115d Bulevar Mihajla Pupina Street,
V floor 11070 • Novi Beograd • Serbia
Tel.: + 381 11 314 96 84
info.rs@saint-gobain.com
www.saint-gobain.rs

Informacioni teknik i paraqitur më sipër dhe rekomandimet bazohen në njohuritë dhe përvojën tonë, në rastet kur produkti ruhet, transportohet, përgatitet dhe përdoret në kushte të rregullta. Blerësi, ose përdoruesi i produktit këshillohet të testojë produktin, nëse është i përshtatshëm për përdorim për qëllimin e synuar. Duke marrë në konsideratë faktin, që nuk kemi ndikim në rrethanat e përdorimit dhe trajtimit të produktit, kompania nuk do të mbajë përgjegjësi për pasojat që vijnë nga përdorimi i parregullt. Blerësi, ose përdoruesi i produktit do të jetë përgjegjës në rast se produkti magazinohet, transportohet, përgatitet, përdoret dhe aplikohet në kundërshtim me udhëzimet, qëllimin, vetitë dhe informacionin mbi sigurinë e produktit, si dhe pas datës së caktuar të skadencës të produktit. Ekipi ynë i ekspertëve me përvojë ofron këshilla në fazat e planifikimit dhe aplikimit të produkteve tona. Vizita në kantierin e ndërtimit dhe demonstrimi i aplikimit të produkteve tona mund të organizohet sipas kërkesës. Kontaktoni ekipin tonë teknik dhe mësoni më shumë për produktet tona në faqen e internetit www.saint-gobain.rs dhe www.saint-gobain.al. Kjo fletë e të dhënave teknike është e vlefshme prej 01.03.2025 dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme për këtë produkt.

weber
SAINT-GOBAIN

Enveo Therm

SISTEME FASADE QË SHKËLQEJNË GJITHMONË

EnveoTherm është një sistem unik termoizolimi, i përbërë nga komponentë të cilësisë superiore, të cilët i kanë rezistuar provave më të vështira. Shumllojshmëria e produkteve, qëndrueshmëria dhe gama e gjerë e ngjyrave do të tërheqin menjëherë vëmendjen tuaj.
www.testisthebest.com

TEST IS THE BEST
tested by the most demanding customers • international european certificate •

SAINT-GOBAIN